

Për:	Operatorin Ekonomik: NARA BIOTICS SH.P.K., Rr. Mbretëresha Teutë, 10000, Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	15.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **14.11.2023**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik: NARA BIOTICS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së:**

LOT II – FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR STOMATOLOGJI

LOT III – FURNIZIM ME BARNAMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR

Me Numër të prokurimit: **623-23-10731-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-065-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Operatori Ekonomik: NARA BIOTICS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së:**
LOT II – FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR STOMATOLOGJI
LOT III – FURNIZIM ME BARNAMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR
 Me Numër të prokurimit: **623-23-10731-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-065-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **10.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdojë me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-23-10731-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-065-1-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: NARA BIOTICS SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së:**

LOT II – FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR STOMATOLOGJI

LOT III – FURNIZIM ME BARNAMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR

Me Numër të prokurimit: **623-23-10731-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-065-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **10.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **14.11.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET E TUA ANKIMORE:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

LOT II – FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR STOMATOLOGJI

Sqarimet janë si në vijim:

Në Dosjen e tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Neni 13.2 është kërkuar:

Shuma e Sigurimit të Tenderit është: 1,000.00 Euro, për periudhë valide prej: 120 ditë

Ju si Operatorë Ekonomik NUK e keni plotësuar formë administrative të përcaktuar në Dosjen e tenderit (**mungon Sigurimi i tenderit**), ku sipas RrUOPP – së, Neni 29 Sigurimi i tenderit, par. 29.7 thotë: *Afati i fundit për dorëzim të sigurimit të tenderit do të jetë i njëjtë si ai për dorëzim të tenderëve. Sigurimet e tenderëve të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderit do të refuzohet dhe kështu do të rezultojë në refuzimin e tenderit,*

Po ashtu Neni 29.13 thotë: *Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar së bashku me oferte.*

Andaj Oferta juaj Refuzohet në bazë të sqarimeve të lartpërmendura.

LOT III – FURNIZIM ME BARNA AMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR

Sqarimet janë si në vijim:

Nuk e plotësoni kërkesën e Sigurimit të tenderit, ju keni dorëzuar sigurimin e tenderit mirëpo jo konform kërkesës dhe rregullave të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, dëshmia e sigurimit të tenderit nuk e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues, sepse ky dokument nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT

Në dosjen e tenderit është dhënë forma standarde e Sigurimit të tenderit e cila duhet të dorëzohet në harmoni me kërkesën e AK-së operatorët ekonomik, mirëpo Sigurimi i tenderit që ju keni dorëzuar është I PA nënshkruar nga Kompania e Sigurimeve, dhe është në kundërshtim me Nenin 57 të LPP-së dhe Nenin 47.17 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pra ky dokument nuk është në pajtueshmëri.

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ në faqen 90 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit